

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit A.H. nga fshati K., komuna e D., për shkak të veprës penale ndihmë në grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 33 të KPK-së dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, duke vendosur përkritazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - DKR Prishtinë, PKR.nr.595/2016 datë 23.2.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës të Apelit të Kosovës – DKR PAKR.nr.255/2017 datë 8.8.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 30 prill 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit A.H., ANULOHEN aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR Prishtinë, PKR.nr.595/2016 datë 23.2.2017 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - DKR PAKR.nr.255/2017 datë 8.8.2017, vetëm sa i përket veprës penale grabitje në ndihmë nga neni 329 par. 3 lidhur me nenin 33 të KPK-së dhe në këtë pjesë çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Në raport me veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, aktgjykimet ngelin të paprekura edhe përkritazi me dënimin e shqiptuar me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) €.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore - DKR Prishtinë, PKR.nr.595/2016 datë 23.2.2017, i dënuari A.H. është shpallur fajtor për veprën penale ndihmë në grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 33 të KPK-së dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, dhe pasi që më parë për secilën vepër veç e veç janë përcaktuar dënimet, dhe atë për veprën e parë dënim

me burgim në kohëzgjatje prej 2 vitesh dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 €, ndërsa për veprën e dytë dënim me gjobë në shumë prej 400€, është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vitesh, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak prej 30.11.2014 gjer më 28.10.2015 dhe dënim me unik me gjobë në shumë prej 900 €, i cili dënim do t'i zëvendësohet me dënim me burgim poqe së nuk paguhet në afatin e caktuar, duke llogaritur një ditë burgim me 20 € të gjobës. Është detyruar që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas fletës definitive mbi shpenzimet, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dëmtuarit E.M. dhe B.G., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, janë udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.255/2017 datë 8.8.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit A.H., Asdren Hoxha, av. nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së Ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe i dënuari të lirohet nga akuza ose të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr.214/2017 datë 10.11.2017, ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, vlerësoi pretendimet e mbrojtësit të paraqitura në kërkesë, në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK-së, dhe konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.8 lidhur me nenin 123 par.5 të KPPK-së, sepse bazohen në deklaratat e bashkë të akuzuarve A1. dhe M.H., prova këto të cilat janë të papranueshme. Më pas, theksohet se dispozitivi është i paqartë dhe në kundërshtim me arsyetimin ndërsa arsyetimi i shkallës së dytë është i paqartë dhe në kundërshtim me shkresat e çështjes, më pas citohet një segment nga arsyetimi i aktgjykimit për të theksuar se aktgjykimi nuk bazohet në deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në shqyrtimin gjyqësor, por në ato të dhëna në hetuesi në cilësinë e të pandehurve.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson si të bazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë për këto arsye:

Me aktakuzën PP/1nr.924/13 datë 27.2.2015, janë akuzuar A1.H1. dhe M.H., për veprën penale grabitje nga neni 329 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK-së, kurse A1.H. për veprën penale ndihmë në grabitje nga neni 329 par. 3 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së. Në shqyrtimin gjyqësor të datës deri sa është zbatuar procedura e përbashkët, të dënuarit A1. dhe M.H., kanë pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, ndërsa i dënuari Arian ka mohuar veprën penale të grabitjes kështu që gjykata ka veçuar procedurën penale kundër të dënuarit dhe ka vazhduar procedurën kundër Ardios dhe Mërgim Hoxha, të cilit i ka shpallur fajtorë dhe gjykuar.

Në procedurën e zhvilluar kundër të dënuarit A.H., gjykata e shkallës së parë ka administruar të gjitha provat e propozuara e ndër të tjera ka dëgjuar në cilësinë e dëshmitarëve A1. dhe M.H. (bashkëpandehur), të cilët në një procedurë tjetër janë shpallur fajtorë dhe janë gjykuar. Këta dëshmitarë në shqyrtimin gjyqësor në dëshminë e tyre kategorikisht kanë mohuar implikimin e të dënuarit A., në veprën penale të grabitjes.

Mirëpo, në shqyrtimin gjyqësor gjatë marrjes së tërthortë në pyetje nga Prokurori i çështjes dhe vënies në dyshim me deklaratat e mëparshme, janë përdorur deklaratat e tyre të cilat i kanë dhënë në cilësinë e të pandehurve, në zyrën e Prokurorit kur si të pandehur, kanë pranuar fajësinë.

Nga shkresat e çështjes dhe aktgjykimet e kundërshtuara, rezulton se gjykata e shkallës së parë konkludimin e saj lidhur me fajësinë e të dënuarit A.H., e bazon ekskluzivisht në deklaratat e këtyre dëshmitarëve të dhëna në procedurën paraprake në cilësinë e të pandehurve. Kështu, në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë, në faqen 7, konstatohet “deklarimet e dëshmitarit A1.H1., në shqyrtimin gjyqësor ishin jo të lidhura, të palogjikshme dhe thellësisht kundërthënëse, duke mos dhënë asnjë arsye të besueshme për ndryshimin e këtyre deklaratave. Është e rëndësishme të theksohet fakti se ky dëshmitar pjesëmarrjen e të akuzuarit A., në veprën penale ka pranuar në deklaratën e dhënë në Prokurori..., në mënyrë shumë të hollësishme ka përshkruar të gjitha veprimet e veprës penale dhe se ideja ka qenë e A. Më pas lidhur me dëshminë e dëshmitarit ish bashkakuzuari M.H., i cili ka deklaruar se me të njëjtin nuk ka qenë natën kritike gjatë kryerjes së veprës penale... gjykata vlerëson se edhe dëshmia e këtij dëshmitari e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, mohimin e tërësishëm të deklaratave të dhëna në procedurën paraprake në cilësinë e të akuzuarit, është vetëm një përpjekje për t'i ndihmuar tani të akuzuarit”.

Vlen të theksohet se sipas nenit 123 par.5 të KPPK-së, parashikohet se deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrë vullnetare dhe pa shtërngim, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit gjyqësor kundër të pandehurit, por jo edhe kundër të bashkëpandehurve. Deklaratat e tilla nuk mund të shërbejnë si provë e vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të pandehurit.

Megjithatë, gjykata nuk ka mundur të bazoj vendimin e saj në këto deklarata për faktin se sipas dispozitës së nenit 123 par. 3 të KPPK-së, deklarata në procedurën paraprake pranohet në shqyrtimin gjyqësor për marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarit të njëjtë (e jo të bashkëpandehurit siç ka ndodhur në rastin konkret), sepse deklarata nga procedura paraprake të cilën e kanë dhënë dëshmitarët ka qenë në cilësinë e të pandehurve dhe këto deklarata nuk kanë mundur të përdoren për arsye se në procedurën e njëjtë penale pala nuk mund të ketë dy cilësi të pandehurit dhe të dëshmitarit, siç në rastin konkret gabimisht ka konkluduar gjykata e shkallës së parë. Këtë ka konfirmuar edhe gjykata e shkallës së dytë, duke e bërë gabimin e njëjtë.

Prandaj, Gjykata Supreme, konstaton se aktgjykimet e kundërshtuara bazohen në prova të papranueshme, shkelje këto të parapara nga neni 384 par.1 pika 1.8 lidhur me nenin 123 të KPPK-së, për çfarë u deshtë që të dy aktgjykimet në raport me veprën penale ndihmë në grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 33 të KPK-së, të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim .

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet t'i evitohet shkeljet e konstatuara, në shqyrtimin gjyqësor, të administrojë të gjitha provat e propozuara si dhe provat tjera të cilat konsideron se janë të nevojshme për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike e më pas të merr një vendim të ligjshëm.

Nga arsyet e dhëna më sipër, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u aprovua si e bazuar dhe në kuptim me nenin 438 par.1 pika 1.2 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
PML.nr.315/2017 datë 30 prill 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta